



№. 12/1 Prot  
dt. 10.01.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 12/1 prot.

Shkodër, më 01.01.2024

**LËNDA:** Mbi vendimet nr.101 dhe nr.102 datë 21.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, gërma a, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54/n, neni 55/2, neni 64/c, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, VKM Nr.384 datë. 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim, sipas ç’do programi social të strehimi dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKB Vau-Dejës Nr.81 date.30.10.2023 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2023”, VKB Nr.48 datë. 28.06.2021 “Për miratimin e planit të strehimit social 2021-2026”, VKB nr.34 date.28.04.2023 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qerases në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”, materialit të dërguar nga Sekretari Këshillit Nr.8034prot datë.26.12.2023 “Mbi miratimin e dokumentacionit shoqërues të mbledhjes së radhes të keshillit bashkiak Vau-Dejës me datë.21.12.2023”, U njoh me VKB Vau-Dejës nr.101 dhe 102 datë.21.12.2023 “Mbi miratimin e përfitueseve Z. Ndrec Tanushi dhe Ardjan Lekaj, të vlerës së subvencionit të qerases sipas programit “Subvencion i qerasë në tregun e lirë”.

Lista e përfitueseve (nominalisht) nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja “a” e ligjit “Për Prefektin” i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**



**VENDIM**

Nr. 101 datë 21.12 2023

**“Për miratimin e përfitimit dhe vlerës së subvencionit të qirasë për z.Ndrec Tanushi në programin “Subvencion i qirasë në tregun e lirë”**

Në mbështetje të nenit 24të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit38 i Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;VKM-së nr.362 prot,datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 “Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026” në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencion i qirasë , në tregun e lirë”; VKB Nr.80 me 30.10.2023 “Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit ” VKB nr.81, datë 30.10.2023 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Subvencionit të qirasë, në tregun e lirë” për vitin 2023; VKB-së nr. 34, datë 28.04.2023 “Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave ”. Proces-Verbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datën 06.12.2023 “Për instrumentin financiar të subvencionit të qirasë, në tregun e lirë”

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e përfitimit dhe vlerës së subvencionit të qirasë për z.Ndrec Preng Tanushi në programin “Subvencion i qirasë në tregun e lirë” , sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga momenti i miratimit i listes së përfituesve me vendim të këshillit të vetëqeverisjes vendore , ( pika 4 neni 39, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet “Drejtoria e Mbrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social”
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

**KRYETAR**  
**Ervis SHIMAJ**

**SEKRETAR**  
**Ardian CELEPIJA**

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me Datë 29.12.2023